



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



## PROCESVERBAL 2/2024

I Mbajtur në takimin e II- të të rregulltë të KPF-së me datën **27.02.2024**, në sallën e vogël të takimeve në ora 10<sup>00</sup> nën kryesimin e Kryesuesit të KPF-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtarës për informim.

### Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. z. Xhavit Zariqi, Kryesues;
2. z. Arian Imeri, Anëtar
3. znj. Lumnije Morina, Anëtare;
4. znj. Mimoza Pajaziti, Anëtare;
5. z. Lulzim Abazi, Anëtar;
6. z. Brahim Osmani, Anëtar;
7. znj. Shqipe Jashari, Anëtare;
8. znj. Hatixhe Bungu Qerimi, Anëtare;
9. z. Flamur Istrefi, Anëtar dhe

### Drejtorët e drejtorive;

1. z. Sabri Murseli, Drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë;
2. z. Balton Dërguti, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit dhe
3. z. Arbër Bytyqi, Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit.

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishëm, anëtarë të kuvendit, shoqëria civile, Drejtor të drejtorive, pra po fillojmë me mbledhjen e II-të të rregullt të KPF-së, besoi që materialin e keni marr me kohë dhe ju dëshiroi mirëseardhje dhe propozojë këtë rend dite:

### Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KPF-së;
4. Propozim – Vendim për Shpallje të Interesit të Përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale; 784-0 dhe 783-0 Z.K. Manastirc, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 138-0 dhe 130-0 Z.K. Manastirc, pronë e Komunës së Ferizajt;
5. Propozim – Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit me nr. 01.Nr. 8486 të datës 30.11.2006;
6. Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevoja të banorëve të Fshatit Nerodime e Ulët;
7. Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevoja të banorëve të Fshatit të Vjetër;
8. Propozim – Vendim për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të lokalit afarist me ngastra kadastrale Nr. 0-72217092-155-2-4-0 Z.K. Ferizaj;
9. Propozim – Vendim për vazhdimin e mandatit të Komisionit për Emërtimin e Rrugëve, Rrugicave dhe Shesheve për kompletimin e sistemit të adresave komunale;
10. Raport i Komisionit për futjen e emrave, të rrugëve në sistemin Aris, numërim dhe vendosja e numrave të objektit e banimit;
11. Propozim – Vendim për caktimin e dy anëtarëve nga Kuvendi i Komunës për Komision për ndarjen e bursave për student për vitin akademik 2023/2024;
12. Raport i Komisionit për verifikimin e pronave të cilat janë dhënë në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër të bizneseve dhe
13. Të ndryshme.

## **Pika 2**

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – A ka dikush rreth rendit të ditës, nëse jo kush është për aprovimin e rendit të ditës; 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet rendi i ditës.

## **Pika 3**

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Pra po fillojmë me pikën e III- të, miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KPF-së, a ka dikush ndonjë vërejtje lidhur me procesverbalin e mbledhjes së kaluar, mbasi nuk ka vërejtje, kush është për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar; 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

## **Pika 4**

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Propozim – Vendim për Shpallje të Interesit të Përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale; 784-0 dhe 783-0 Z.K. Manastirc, pronë private, me qëllim të

këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 138-0 dhe 130-0 Z.K. Manastirc, pronë e Komunës së Ferizajt, drejtor a mundesh me na shqaru lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

**Sabri Murseli** – Faliminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë anëtarë të e KPF-së, media dhe të gjithë të pranishmit, ky propozim vendim ka të bëjë me shpallje interes të përgjithshëm të këtyre dy pjesëve të ngastrave kadastrale 784-0 Z.K. Manastirc me sipërfaqe 384 m<sup>2</sup> pronë private e Vehbi Ramusholli dhe 783-0 dhe pjesën e ngastrës kadastrale me sipërfaqe 1830 m<sup>2</sup> gjithsej me sipërfaqe totali 2214 m<sup>2</sup>, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 138-0 Z.K. Manastirc me sipërfaqe 151 m<sup>2</sup> dhe pjesa e ngastrës kadastrale 130-0 Z.K. Manastirc me sipërfaqe 377 m<sup>2</sup> gjithsejt me sipërfaqe totale prej 5.28 m<sup>2</sup> janë prona të Komunës së Ferizajt, pala është e interesuar që 5.28 ari që është një parcel në pronën e komunës sepse ka shpija përreth dhe që kjo pjesë të bëhet pronë private dhe të këmbehet me ate publike, qëllimi është 5.28 ari për këtë rrugën e ngushtë të këmbehet me 22.14 ari, pala ja jep rrugës. Pra me këmbim del komplet kjo pjesë e komunës.

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Faliminderit, urdhëro.

**Barahim Osmani** – Cilin vit është rruga aty?

**Sabri Murseli** – Nuk kam informata se një pjesë e rrugës nuk është e asfaltuar, pritët të asfaltohet, ka mundësi, në teren shihet që është asfaltu rruga.

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Faliminderit, dikush tjetër pra a jeni që të kaloi pika e IV-të e rendit të ditës në kuvend; 7 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet pika e IV – të e rendit të ditës, po fillojmë me pikën e V-të të rendit të ditës.

## **Pika 5**

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Propozim – Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit me Nr. 01.Nr. 8486 të datës 30.11.2006, drejtor për cilin vendim bëhet fjalë.

**Sabri Murseli** – Kryesues për këtë Propozim – Vendim bëhet fjalë që përmes këtij vendimi i është nda një sipërfaqe të parcelave në Fshatin Prelez të Jerlive, por është nda në fund të parcelës, propozimi i fshatit është i qartë që të ngjitet në varrezat aktuale edhe të vazhdohet me një anë të parcelës dhe të bëhet parcelë e re, është e njejta vetëm ngjitur me parcelë të vazhdohet, por është nda në fund të parcelës dhe t'i ngjitet me varrezat aktuale dhe të bëhet parcel e re, është e njejtë vetëm të vazhdohet dhe të ngjitet me parcela tjera, kjo ndahet me një pjesë se është në fund të parcelës, ka të bëjë me ndryshimin e koordinatave. Kjo parcel është ngjitur me varreza, vazhdohet me varreza qat pjesë, 2006 janë nda, por ende nuk kanë inplementime, kështu që është ma e mirë në këtë formë sepse është keqë që me i ba dy par varreza me lokacion dikund tjetër.

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Faliminderit drejtor, a dëshiron dikush të diskutoi për këtë pikë, kush është që të kaloj në kuvend pika e V-të; 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet pika e V –të e rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e VI-të.

## **Pika 6**

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevoja të banorëve të Fshatit Nerodime e Ulët;

**Sabri Murseli** – Faliminderit Kryesues, ky propozim vendim ka të bëjë me ndërtimin e objektit për nevoja të komunitetit, në bazë të vendimit të pozitive administrative të shqyrtimit, në bazë të komunës, thotë shojca 7 mos gabofsha komuniteti nuk i nënshtrohet ligjëshmërisë, simbas udhëzimit administrativ që e rregullon bashkëpunimin e fshatrave me qytetin, e obligon kryetarin me lidhë marrëveshje, na me këtë vendim i lejojmë komunitetin me ndërtu, mirëpo duhet me pas një marrëveshje, qysh ka me u mirëmbajtë, nëse komuniteti nuk mundet me mirëmbajt marrëveshjes, kjo marrëveshje menjëherë i kalon në menagjim të komunës, sepse ata duhet me marr përsipër rrymën, ujin, të gjitha, mirëmbajtjet që duhet t'i ketë një objekt, përmes këtij vendimi na e lëshojmë lokacionin, e lëshojmë lejën ndërtimore, mirëpo ndërtimi, financimi i projektit komplet bëhet i komuniteteve edhe mirëmbajtja e tyre.

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Faliminderit drejtor, a dëshiron dikush ta merr fjalën, nëse jo a jeni të kaloi në kuvend pika e VI-të e rendit të ditës; 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet pika e VI –të e rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e VII-të të rendit të ditës.

## **Pika 7**

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevoja të banorëve të Fshatit të Vjetër, urdhëro drejtor.

**Sabri Murseli** – Kryesues edhe kjo pikë si pika e më parme është e njëjtë por vetëm ka një dallim, një anëtarë i kuvendit z. Naseri ka kërkuar që objekti i gjendjes civile të lejohet për shfrytëzimin për nevoja të komunitetit, gjatë kërkesës dhe takimit që këna pas me z. Naserin që një pjesë e parcelës të ndahet për objekt të gjendjes civile, sepse komuna ka qëllime në forma tjera për atë objekt për me shfrytëzu, kjo parcelë është përballë zyrës së vendit, zyrja e vendit është këtu, e parcela është me sipërfaqe prej 5 ari, por prap këtë informatë duhet ta konfirmojë në kuvend vet z. Naseri, sepse kjo parcelë ka thanë që banë me u nda edhe tokë, sepse nëse z. Naseri është dakort me lanë tokën, atëherë është në rregullë, e nëse nuk është në dakord komuna për objekt ka plane tjera me shfrytëzu, për arkiva apo për çështje tjera, me mirëkuptim jena marr vesh me qit këtu, e në kuvend ta shohim si do ta vendosim, faliminderit.

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Faliminderit drejtor, a dëshiron dikush tjetër ta merr fjalën, urdhëro Flamur.

**Flamur Istrefi** – Faliminderit Kryesues, unë mendoj që bordi drejtues, realisht thotë se parcela e objektit të vjetër të gjendjes civile edhe që është me nënshkrime të fshatarëve, kështu që arsyetimi në bazë të këtij vendimi duhet me gjetë lokacion d.m.th. dikund tjetër edhe që ka mu ba ndërtimin i objektit me pagesë të bashkëfshatarëve dhe kjo është në shpërputhje me këto, z. Naseri a është Kryetar i fshatit, jo, z.Naseri duhet me pru një kërkesë me shkrim që me sjellë në kuvend, e në këtë formë ka dallim vendimi me kërkesën, këtu d.m.th nuk mundesh me obligu dikand që me kërku me ndërtu një objekt tjetër, kërkesa nuk thotë që ne e ndërtojmë me mjetet tona, me financa tona një objekt, ta japim në shfrytëzim objektin e gjendjes civile, e t'i kem mundur me refuzu dhe me i thane bane një kërkesë tjetër për ndërtimin e një objekti me mjetet e juve, se qysh unë me procedu këtë në kuvend, kryesues.

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Faliminderit, një shqarim, kërkesa për këtë objekt po ju ofroj më një hapësirë për një objekt për nevoja të komunitetit, nëse ju konvenon mirë e japim e nëse jo nuk e kemi pa qare me dhanë, pra ky nuk është vendim por është propozim, na nuk mundemi mi dhanë objekt, por mi dhanë hapësirë për ndërtimin e objektit.

**Flamur Istrefi** – Mirë po duhet me dhanë arsyetim me shkrim.

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Këtu në propozim është, por në kuvend Naseri e tregon më së miri gjendjen, nëse ju konvenon e japim, nëse jo nuk kemi çka me ba, u kry një punë.

**Sabri Murseli** – Na me Naserin kemi bisedu, por në kuvend duhet me vendos a me ja dhanë tokën për ndërtim, e nëse është nevoja na Naserit i kërkojmë me na dhanë me shkrim, a e marojme, a se marojmë objektin, kjo është për nevoja të fshatit, kjo është kërkesa e një personi apo një anëtar i kuvendit.

**Flamur Istrefi** – Ta banë në mënyrë të rregullt, ta bane një kërkesë prej banorëve me nënshkrime, e mandej është në rregullë.

**Sabri Murseli** – Për mua qysh kalon në rregullë jamë.

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Faliminderit drejtor, a dëshiron dikush ta merr fjalën, nëse jo a jeni të kaloi në kuvend pika e VII-të e rendit të ditës; 8 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet pika e VII –të e rendit të ditës, po fillojmë me pikën VIII-të.

#### **Pika 8**

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Propozim – Vendim për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të lokalit afarist me ngastra kadastrale Nr. 0-72217092-155-2-4-0 Z.K. Ferizaj, urdhëro drejtor.

**Sabri Murseli** – Ky propozim – Vendim ka të bëjë me vendimin e fundit të kuvendit që është Propozim - Vendim për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim afat shkurtër të lokalit afarist me ngastra kadastrale Nr. 0-72217092-155-2-4-0 Z.K. Ferizaj në qendër të qytetit, e që ka ardhur prej ministrisë që komisioni duhet të formohet prej 5 anëtarëve; 2 anëtarë nga ekzekutivi, 2 anëtarë nga kuvendi - legjislativi dhe një anëtarë nga subjekti jo qeveritar (OJQ) dhe duhet ta shohim procesverbalin kur vjen në seancë për miratim, faliminderit. Besoi që i keni emrat për seancë.

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Faliminderit drejtor, a dëshiron dikush ta merr fjalën, nëse jo a jeni të kaloi në kuvend pika e VIII-të e rendit të ditës; 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet pika e VIII –të e rendit të ditës të kaloi në kuvend, po fillojmë me pikën e IX-të të rendit të ditës.

## **Pika 9**

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Propozim – Vendim për vazhdimin e mandatit të Komisionit për Emërtimin e Rrugëve, Rrugicave dhe Shesheve për kompletimin e sistemit të adresave komunale, kush është prej drejtorave që dinë me na sqaru lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, sepse Komisioni i emërtimit të rrugëve e ka përfunduar mandatin, mund të ketë najherë naj kërkesë për emërtim të ndonjë rrugice të vogël apo që ajo mund të bahet, e bajmë një komision për vlerësim, e qesim në kuvend, unë nuk e shohë të arsyeshme me ju vazhdu kontratën Komisionit të rrugëve e me marr paga gjatë tërë vitit, nuk e shohë të arsyeshme me ju vazhdu mandati Komisionit për emërtim të rrugëve deri sa nuk kanë çka me ba, nuk kanë asnjë obligim, po megjithatë na e diskutojmë dhe e marrim një vendim, udhëro drejtor.

**Arbër Bytyqi** – Faliminderit kryesues, këtu në propozim është ba një gabim në emërtim se nuk është Komisioni për Emërtimin të Rrugëve, Rrugicave dhe Shesheve por ka të bëjë me futjen e emërave të rrugëve, rrugicave dhe shesheve e adresave në sistemin ARIS, që duhet me u përmirësu, përndryshe ky komision nuk i ka ato kompetenca, po unë po besoi se edhe një vit të vazhdoi mandati i këtij komisioni sepse është i domosdoshëm që Drejtoria e urbanizmit dhe mjedisit që e ka këtë kompetencë nuk ka staf të mjaftueshëm për ta kryer këtë përgjegjësi, është Komision komplet teknik, përveç nëse doni ju me i dhanë mandat shtesë si kuvend komunal, përndryshe përgjegjësit e komisionit janë kompetencat teknike që duhet me u përfunduar, për shkak se kemi edhe obligim ligjor për me e shti në sistem, ju keni pa që veç ka fillu sistemi i vendosjes të shenjave të emrave të rrugëve, rrugicave dhe shesheve në teren edhe ky komision e ka përgjegjësi me i përcjellë vendosjen, implementimin e rrugëve, rrugicave dhe shesheve në bazë të sistemit të adresave në sistemin ARIS, propozimi duhet me qenë kësi soi; Propozim – Vendim për vazhdimin e mandatit të Komisionit për futjen e emërtimit të rrugëve, rrugicave dhe shesheve në sistemin e adresave komunale ARIS, faliminderit.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Faliminderit drejtor, d.m.th. bëhet fjalë për vazhdimin e kontratës jo për emërtim të rrugëve por futjen në sistem të emrave, kjo është një punë tjerër që duhet me ba.

**Arbër Bytyqi** – Po kryesues, ende nuk është futur në sistem.

**Brahim Osmani** – Përshëndetje për të gjithë, unë besoi që nuk ka përfunduar emërtimi i rrugëve kryesues, ka ende rrugica që nuk janë futur në sistem, dhe unë dëshiroi që kjo punë të kryhet, e qysh po e shohë unë emrat e këtyre të komisionit, njani prej tyre koka për të dhëna nga tereni, ky ka qenë edhe një komision ku edhe me një far forme i ka ndihmu për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave, nuk po du me ju kthi asaj kohe, por duhet me ditë qysh i kanë vendos dhe qysh i kanë ndryshu, e dyta koordinator Faik Selmani, kurgja personalisht nuk kam me te, por nuk mujna me ja caktu një asambleisti pagën mujore për shkak se edhe është shkelje e ligjit, konflikt interesi, se nuk mundet për shkak se Ligji i pagave thotë se nuk mundet një anëtar i kuvendit të ketë një rrogë tjetër, qysh e keni leju, ma mirë e kanë, mu kanë komision edhe në atë komision të punohet se që në këtë formë që e keni bërë ju, kjo është shkelje ligjore, kjo mund me kalu, ne mujmë me nal, por MAPL-ja ka me kthi jashtë ligjit sepse një anëtar i kuvendit me pas një pagë tjetër, qysh e keni cek ju, një pagë mujore në vlerë prej 500.00 euro, kjo është gabim dhe shkelje ligjore e që duhet me përmirësu edhe një herë me pru këto me përmirësime, qysh tha kolegu edhe mundet me kalu, por unë po ju tregoi që vet kam me dërgu në MAPL dhe me kthi jashtë ligjeshëm, se nuk mundet një asambleist të ketë pagë shtesë, faliminderit.

**Arber Bytyqi** - Sa i përket zyrtarit të fundit kjo është pa plotësim ndryshim, para dy muajve nëse nuk gaboi në kuvendin komunal të Ferizajit edhe tash së fundi është pjesë e komisionit, e herën tjetër ka qenë tjetër zyrtar, ndërsa sa i përket qasjes së kompenzimit unë nuk besoi se që kjo duhet të trajtohet si page, është çështje e kompenzimit si lloj meditare dhe nuk hinë në atë kategorinë e pagesës së pagave komunale, është kategori tjetër e buxhetit ku bëhet kompensimi për këta zyrtarë, gjithsesi mund të analizohet aspekti ligjor, a kemi të drejt në këtë aspekt që një anëtar i kuvendit me ja dhanë pagën apo mbetet një propozim i juaji, a mund të kaloj, po unë nuk besoi se kjo hinë në kategorinë e pagave.

**Mimoza Pajaziti** - Një pyetje po du me ja ba kolegut, Ju që keni qenë në komisionin për zgjedhjen e Kryetarit të fshatrave, sa jeni pagu dhe a ju lejohet juve me ju pagu, unë e di që janë pagu.

**Brahim Osmani** - Nuk ju kena pagu, por e di që me ligjin për vetëqeverisje lokale, e cek në momentin që je në komision duhet të paguhen në bazë të komisioneve obligative, a paguhet a nuk paguhen nuk e di hala, unë mendoi se mirë kishte me qenë me u pagu, unë po du prap me u lidhë te drejtori, po e shohe qe tre po paguhen 500.00 euro në muaj, mënyra qysh e ka ba të paguhet në 500.00 euro në muaj është jashtë ligjeshëm se prap MAPL –ja ka me kthi.

**Mimoza Pajaziti** - A ta jap një sqarim, kështu nëse njëri prej këtyre nuk janë prej anëtarëve të kuvendit mundet me marr rrogën 500.00€, përjashtim p.sh. po e llogaritem nëse MAPL-ja e kthen z. Faikun, atëherë mbetet 30% edhe mundet me marr, nuk d.m.th. për shkak të Faikut.

**Brahim Osmani** - Nuk thash ashtu.

**Mimoza Pajaziti** - Unë po e them këtë, nuk mundemi tjerët me i deklasu për shkak të Faikut, unë mendoj kryesues, kështu që jemi teper vonë, hala emertimi i rrugëve nuk ka hy në proces në mënyrë elektronike, e na po e diskutojmë për çështjen e pagesës, e ato kanë çështje tjera teknike që munden d.m.th. me i sqaru mandej, mendoj që është mirë të mos ndalemi për këtë çështje, faliminderit.

**Brahim Osmani** - Se këto janë çështje teknike.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Gabimi më i madhë është bërë kur është marr vendimi për me dhanë pagë, është e pa logjikshme mi dhanë pagë komisionit, komisioni mund të kompenzohet me meditje, me orë pune, me ditë pune, jo komisioni me marr page mujore, nuk ka logjikë, asnjë logjikë nuk e ka, e kena ba, ata rrin një vjet e shkojnë një ditë në punë, e marrin pagë mujore nuk ka logjikë kjo, udhëro.

**Flamur Istrefi** - Faliminderit kryesues, unë mendoj se ky komision ka pasur një afat edhe me sa po shohë që ky komision punojnë edhe punë tjera, ky djali punon në “Bifurkacion”, kur e merr kohën me punu në komunë është pak problem, asnjë vjet nuk mund t’ia dalin, me këtë ritëm ka me shkua edhe 5 vjet, prandaj ka me pas me u rregullu edhe çështja e angazhimit të orarit, a angazhohet dy orë në ditë, apo tri orë në ditë se është problem me thane, se nëse janë angazhu në punë tjera dhe nuk munden me i kry për një vit, me këtë ritëm nuk kryhet.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Dhe nuk është interesi i tyre me i kry, pse me i kry, me i marr nga 500.00 euro në muaj edhe me kry, nuk ka logjik me kry.

**Arbër Bytyqi** - Pika mbas kësaj ka me qenë raporti, në raport kena me pa secili prej asambleistëve punën e këtij komisioni, unë po besoi që mos t’i shanë ky komision, na ishim maskeqti në nivel të Republikës së Kosovës, me sa i përket emërimit të futjes në sistem të rrugëve, adresave dhe shesheve, unë mendoj që kanë punu, janë angazhu, kena pas telashe me pozicionimin në teren vendosjen në teren, te çështja e vendosjes së numrave të emrave të rrugëve, por nuk varet prej neve edhe çështja e komisioneve është çështja e tenderëve që do të shpallen në fazat dhe procedurat të tenderimit dhe shenjëzimit, unë po besoi se është mirë të përfundoi si proces, pas kësaj kur përfundohet ky projekt pastaj mujmë me vazhdu me angazhu ndonjë zyrtar të komunës si punë shtesë, për ndryshe deri sa të kompletohet sistemi ARIS me gjitha rrugët, me emra të rrugëve dhe shesheve, unë po besoi që duhet ta kemi një komision që ky komision të funksionojë dhe ky proces për shkak të projektit ligjor edhe raportimin në ministri të vazhdueshëm sa i përket këtij procesi.

**Shqipe Jashari** – Drejtor, mbasi paska pasur problem tenderimi dhe vonesat në tenderim, pse gjatë kësaj kohës ka problem të krijohet komisioni, deri sa nuk kanë punu.

**Arbër Bytyqi** – Jo Shqipe kanë punu, tash e shef që kanë punu,

**Shqipe Jashari** – Për sa vjet nuk kanë mundur me i vendosur emrat e rrugëve në sistem, qysh mundet sa vjet të punohet me emra të rrugëve dhe nuk janë vendosur në sistem, këta kanë edhe një punë tjetër, kur po punojkanë, nëse është prej 8.00-4.00, kur po vijnë ata me punu në këtë sistem, se edhe ligjërishtë më shumë se 40 orë pune nuk lejohet me ba, atëherë kur i paskan ba këto.

**Arbër Bytyqi** - Shqipe te çështja e punës keni me pa në Raport të punës dy vjeçare në teren, kanë punu, janë angazhu, kanë kry punë të mëdhaja, kështu që mos të ishte kanë ky komision nuk ishin kry.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Drejtor mos thuaj se mos ishte ky komision nuk ishin kry këto punë, unë po them nëse nuk ishte ky komision, e kishim formu një komision tjetër prej punëtorëve, këtu sepse dy punë në të njejtën kohë nuk mundet me ba, një orar është prej 8.00-4.00 te dyjat nuk munden me i ba logjikisht, por nuk po them që nuk kanë punu, ata kanë punu diçka edhe normal deri sa ky numër i madh i emërtimeve dikush e ka ba atë punë, unë nuk e di qysh doni, por komisioni duhet të formohet prej punëtorëve të komunës edhe ja cakton vendin e punës për një vit, 200 vet i ka komuna në punë.

**Arbëri Bytyqi** – Prej punëtorëve të rregullt të komunës asnjë nuk del në komision.

**Brahim Osmani** - Vetëm e kam një pyetje për drejtorin, a ka përfundu emërtimi i rrugëve apo jo, unë them se ka rrugë që nuk janë emërtu t'i po thua se ky komision vetëm ka me i sistemu.

**Arbëri Bytyqi** – Me vendim të kuvendit të Vitit 2019 ka përfundu procesi i emërimit të rrugëve këto qysh janë, është një listë rezervë e rrugëve edhe Drejtoria e Urbanizmit e ka kompetencën e vet në bazë të kërësës së qytetarëve prej listës rezervë me i emërtu dhe na si drejtori e kemi obligim që emrat e ri që janë në listë rezervë t'i bijmë në kuvend, përndryshe për emërtimin e rrugëve është përfundu gjithshka, siç thash edhe më herët këto vetëm janë punët e komisionit.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Dikush tjetër urdhëro,

**Arian Imeri** – Faliminderit kryesues, sa po e shohë janë përfundu të gjitha shënimet dhe janë gati të futen në sistemin ARIS dhe që nevoja për komisionin është, i kemi dhanë dy mandate, njani ka qenë për emërtimin e rrugëve dhe e fundit ka qenë për sistemimin e adresave në sistemin ARIS, prandaj unë mendoj që është mirë me vazhdu mandatin, sa i përket koompenzimit le të del në kuvend dhe të shiqohet rasti i Faikut dhe të tjerëve dhe d.m.th. që është mundësia me gjetë forma të kompenzimit të përgjithshëm.

**Mimoza Pajaziti** – Unë mendoj që këtij komisioni duhet me ja dhanë dritën jeshile për me kompenzu, kryesues qysh prej Vitit 2013 që kam qenë në mandatin e parë të kuvendit të komunës d.m.th ka qenë një komision për emërtim të rrugëve, mandej e kanë ndërpre dhe ka shku largë pa u punu, unë jam me vazhdu, nuk është me rëndësi kush është.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Nuk ka pas.

**Mimoza Pajaziti** – Ka pas komision për emërtim.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Nuk jam tu fol për komision për emërtimin e rrugëve, por po them, nuk a pas komision për futjen e emrave në sistemin ARIS.

**Mimoza Pajaziti** - Kryesues qe 10 vite kjo punë nuk po kryhet, normal kur të ndrrohet komisioni kështu shkon zhag.

**Faik Selmani** – Ky raport ka qenë dashtë mu kanë një pikë më naltë.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Nuk ka lidhje.

**Faik Selmani** – Po ka lidhje, po e sqaroj pse ka bazë te ky raport, i ipet propozimi me kalu apo jo, na e kena pru raportin e këtij komisioni, që u kanë patjetër me u ba ky komision, e kena pru raportin për punë që është ba deri më tani edhe punët që kanë mbetur të bëhen edhe në bazë këtyre punëve, shka kanë mbet me u ba në të ardhmen, ju mundeni me vendosë se a me ja vazhdu a jo mandatin e këtij komisioni, nuk është kjo me orar qysh po thoni ju, por është me orar të plotë ky komision, i vetmi ky person është ai i GIZ-it që e kemi të domosdoshëm atë person, që i vetmi është ai që punon në këtë sistem, ai punon mbas orarit prej orës 4-12 të natës e ka obligim me ardh në zyre, krejt qato punë që i bajmë gjithë ditën me verifikimet në teren, me numra me adresa me kejt, vetëm desha me ju tregu edhe diçka 50000 numra në teren janë verifiku, secilit numër u dasht me ja shkru me tabal me adresë, ku ka me u vendos tabela me ka krejt, tanë kohën në terren tre vet me u marr, në borë në shi, u dashtë me dal, me i ba qoto punë, për me i shti në sistem, na nuk jena tu marr vendim, si po shohë disa duke thanë keni ba ndrrime, jo nuk keni ba, na jena tu e implementu vendimin e 2019-tës në sistemin ARIS, jena duke i ba përgatitjet qysh me i vendos edhe në teren, kjo është puna që jena tu e ba, edhe na jena tu punu me orar të plotë, mu më kurtalisni, sot po ju them, me më hjek prej këtuhit se jam tu përdor barna për shkak të presionit, se kam qaq presion, tanë ditën nuk ndalen për me ardhë në zyre dhe befasoheni se çka nini aty, nini për emërtimin e rrugëve që janë ba në Vitin 2014 që po thu t'i nuk ka pas komision.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Komision ka pas, por nuk ka pasur komision për me futur në sistem, 2014 nuk ka pas as 2015 nuk ka pas, e tash po flasim për komision për me futur në sistem, Faik nuk ka mundësi me punu me orar të plotë në dy puna.

**Faik Selmani** – S'ka tjetër kush, gjeni ju një person që punon në këtë program, nuk ka krejt Kosovën që punon dikush me këtë program.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Nëse ashtë i vetmi në Kosovë atëherë është në rregullë por ka mundësi ai me punu edhe në Ferizaj edhe në Prishtinë.

**Faik Selmani** – Këtë raport që e kena pru, e kena pru me ju njoftu se çka është punu qe dy vite, që po e shofë që ju duket se sen nuk kena punu, po du në detale me ju kalxu se çka kena punu.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Vetëm nëse kenë detale me na kalxu dhe të gjitha këtu i kena të shkrome.

**Faik Selmani** – Çka është të keni këtë raport, 4 anekse janë dikund 1000 faqe po nuk kena mundur me i shtyp këtë, se ka shumë material edhe në këto anekse i keni të sqarume në detalje, çka kena digjitalizu në sistem prej Vitit 2019, çka kena shti në sistem, emërtimet e rrugëve dhe krejt këto i keni të dhanunat me komente në këto anekse, këto nuk kena mujt me i shtyp se kishte me shku shume material, unë mbasi nuk paska nevojë me lexu se çka kena ba dhe në bazë të

tyre, tani ju vendosni a me vazhdu a jo kjo pikë, është dashtë me u kanë më herët për me mujt ju me vlerësu.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Në rregullë, unë mendoj që përbërja e komisionit nuk besoi që duhet të jetë.

**Faik Selmani** – Punët që duhen të bëhen në të ardhmen, vetëm në detale do të shkojë, janë edhe 25 emërtime që nuk janë futur në sistem, është punë gjeometrike e nivelit qendror, në momentin që na e kryejmë atë, tjetërkush nuk i përpunon, ato na duhet emrat e rrugëve me i shti në sistem dhe duhet me dal në teren dhe një nga një me i identifiku, me i përcaktu për shka shërbejnë, për afarizëm, për apo diçka tjetër, krejt ato informacione një nga një duhet me i mbledhur, në qoftëse nuk e plotëson qat formularin, qat sistem automatikisht nuk të lejon me kalu tutje, qaq shumë informacione i ki dhe qëto ndryshime mes GIZ-it dhe ARIS-it më herëshëm, për këtë janë këto punë shtesë d.m.th. 25 rrugë janë pa përfundu, janë 96 rrugë që kërkojnë dhe janë të skicuara, i kemi shti edhe emrat, mirëpo kanë pësu ndryshime në teren, edhe qëto ndryshime duhet niveli qendror me rishikue, ka zgjatje të rrugës që dy vjet dhe këto duhet me i korrigju, këto rrugë janë në pritje d.m.th nuk janë përfundu, jena tu i përpunu të dhanat vazhdimisht se po na ndryshon gjendjen p.sh objektit të “Vëllëzrit Gërvalla” një moment që bëhet një ndryshim, aty vijnë ato numra të mëdhenjë automatikisht, duhet me i përfundu të dhënat, numrat që na vijë duhet me i ba radhitjet, vendosjen e tabelave, kuptoni, që është urgjent që kjo që na duhet si komunë me përmbyll sa më shpejtë, se mujmë me rreziku komplet procesin e tabelave, numrat kanë me i vendos niveli qendror, janë 50 numra dikun 500,000.00€ vlerë ato janë kanë donacion, ata i kanë marr përsipër, na duhet me kry punën tonë me i vendos tabelat me emra në teren, s’pari duhet me hy në sistem komplet, me i vendos në teren, me ju dhanë mundësinë, numrat në të ardhmen me i vendos, qato numra që kanë me u vendos në teren, duhet një ekip i plotë, pra për këtë po them se nuk duhet me shku dy tre, sepse është e nënshkrume në memorandum, bashkëpunimi mes komunës dhe axhensionit dy vjet qysh është kanë e shkruar; aty thotë komuna e ka për obligim me mbështet me hart dhe me transferu edhe nëse ato nuk vijnë në dy ekiye duhet me shku dy vetë, dy persona që dinë me lexu hartën me shku një nga një, me ja caktu ku kanë me vendosë numrat, nuk është e thjeshtë, njani ka me shku me letër informuse qaty ku vendoset harta dhe numri, automatikisht duhet edhe letra informuese, është një letër informuese ku përcaktohet adresa, shkruhet emri mbiemri edhe ka me pranu pronari, ka me nënshkru, një kompje i mbetet pronarit një kopje ka me ju kthy në arkivë, tre vet automatikisht kanë me qenë në teren, është në sistem të brendëshëm që ka mi përcjellë të dhanat prej kompjuterit vazhdimisht në terren edhe unë jam koordinator i krejt këtij ekipi, tash tjetra, e thash vendosjen e tabelave te pjesa e jonë te emërtimet si të vendosen tabelat për emërtime, menjëherë janë në nivel qendror për vendosje të tabelave, e kena pas një takim në janar dhe na kanë dhanë udhëzimet qysh ka me ndodh vendosja e numrave, ata na kanë thënë për afërsisht që këto 50000 numra munden me u kry dikun për tetë muaj në bazë qysh na kanë thënë ata, po unë po them nëse mujmë me i kry për një vjet është sukses, se nuk po mujshin përmbi 100 numra në ditë, një njeri nuk po mujke mi vendos kurqysh, 50000 numra kanë me u vendos, ky është donacion i nivelit qendror, ndërkombëtar dhe shkon përmes nivelit qendror edhe na vetëm kena me mbështet, nëse vijnë me dy ekiye e dy vetë me harta ku t’ia përcaktojmë na, ata kanë me i vendos, nëse vijnë me më shumë ekiye, na me këtë përmbamje që jena, na nuk mundemi me ba kurgja, nuk mujna me organizu, çka ka tjetër, janë edhe 120 kërkesa të reja që i përmendi drejtori, na nuk vendosim për ato kërkesa, na vetëm i kena kompletu dosjet koplet, se na jemi prej 2019, e dimë në detalje se çka kërkojmë para se me

vulos drejtori, na ja kompletojmë dosjet, kërkesa 120 me numra, nënshkrime me biografi etj., i kena përcjell ministrisë ata kanë me na aprovu këtë, si të na aprovojnë na i kthejnë, na i thojmë drejtorit me vendos me marr vendim, në momentin që drejtori merr vendim, na automatikisht duhet me i përpunu në sistem, duhet me i shti emrat në sistem qato që janë 120 kërkesa edhe me i fut numrat, numrat menjëherë duhet me dalë në teren se na nuk i kena të gatshëm numrat, në teren duhet me i identifiku, tjetër është urgjent kjo punë, na jena me sjellë në kuvend ju bani çka të doni.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – A jeni të kaloi në kuvend kjo pikë.

#### **Pika 10**

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Raport i Komisionit për futjen e emrave, të rrugëve në Sistemin ARIS, numërim dhe vendosja e numrave të objektit e banimit në sistemin ARIS, a ka dikush të diskutoi për pikën e X-të të rendit të ditës apo ta procesojmë në kuvend, pra kalon; 7 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet pika e X –të e rendit të ditës, po fillojmë me pikën e XI-të.

#### **Pika 11**

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** –Propozim – Vendim për caktimin e dy anëtarëve nga Kuvendi i Komunës për Komision për ndarjen e bursave për student për vitin akademik 2023/2024, drejtor e keni diçka lidhur me këtë pikë apo po e procesojmë për kuvend, dikush tjetër, pra kalon; 7 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet pika e XI –të e rendit të ditës, po fillojmë me pikën e XII

#### **Pika 12**

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Raport i Komisionit për verifikimin e pronave të cilat janë dhënë në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër të bizneseve, drejtor kur e bjenë në kuvend raportin duhesh me u konsultu me dikend, kurrkush nuk ta ka kërkuar këtë raport, kena lyp raport për qytetarët ose bizneset që kanë marr prona dhe nuk kanë fillu me biznes d.m.th e kanë në pronë tyre, por nuk kanë fillu në bazë të projektit të paraqitur në kuvend, e që baza ligjore të projektit e ka marr pronën dhe me vite nuk e ka shfrytëzu, dhe kjo kërkesë nuk është ba rastësishtë por u ba për arsye se me emru destinacionin e asaj prone nga x personi ose kompania dhe në komunën ose në pronën e komunës, ju keni shku e keni ba komision, fotografi, krijimin e biznesit, lejen e ndërtimit, fotografën qysh duket objekti për gjitha bizneset që kanë marr pronë e që numri i tyre punojnë dhe kanë punësuar njerëzit, ky ka qenë interesi pse e kanë marr dhe interesi i komunës që ju ka dhanë në shfrytëzim atë pronë, por ne nuk e këna lyp kështu, sa biznese që nuk e shfrytëzojnë pronën e komunës dhe na me marr vendim me ja marr atë pronë, tash çka me ba na me këtë raport, a me ja nisë për secilin veç e veç, tre muaj duhet me u marr me këtë punë, e që neve nuk na intereson hiç.

**Sabri Murseli** – Nëse më lejohet.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Nuk lejohet se unë jam duke folur, drejtor në kuvend është kërku dhe votu për pronat e pa shfrytëzuara të qytetarëve ose kompanive që i kanë marr dhe nuk i shfrytëzojnë dhe nuk zhvillojnë biznes me na raportu dhe na me marr vendim, tash kujna me ja marr pronat e këtyre, ky a e ka vendimin e ATK-së, e ka fotografën e objektit, e ka lejën e ndërtimit, qysh ja merr, nuk ka logjik me ja marr, ata që kanë veprimtari për neve është mirë dhe mirë që kanë dhe duhet me ja vazhduar, nuk kena çka me diskutu se të vazhduar e kanë për 99 vjet, e ata që nuk e kanë shfrytëzu atyre duhet me ja shkëput kontratën.

**Sabri Murseli** – Kryesues, nese më lejohet, në kuadër të këtij raporti janë 45 biznese në afat të gjatë dhe afat shkurt 45 janë, prej këtyre janë dy persona që nuk e kanë shfrytëzu një në Varrosh e tjetri në Rahovicë, nuk po folim me emra, njani afat shfrytëzues për 50 vite dhe hiç nuk e kanë shfrytëzu, ndërsa sa i përket bizneseve kena probleme serioze që duhet pak më shumë me u marr me ta, na duhet me u marr, raporti u ba në bazë të ligjit qysh e thotë ligji; Raport i Komisionit për verifikimin e pronave të cilat janë dhënë në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër të bizneseve, janë fut të gjitha bizneset në lista, unë personalisht kam dal me auditor kombëtar, 5 biznese sa i kam vizitu, asnjë prej të pestave nuk ju kanë përmabajt kontratave që i kanë marr me një subjekt, ka biznes që janë shfrytëzu me një subjekt, e në emër tjetër si p.sh . në emër të vllaut, pra ai biznes nuk mundet me u bart në emër të ndonjë anëtarit të familjes, tjetri e ka marr për diçka tjetër, i ka lyp 10 punëtorë tash nuk ka punëtorë, kishe janë tu punu me komisione që duhet me u marr me këtë punë, i vetmi person që meriton me u vazhdu afati është Feidi që ju ka djeg biznesi atij, duhet me ju ofru një organizim të ndërmarrjes me ja dhanë një afat dy, tri për riorganizim, përkundër të gjithë duhet me i shti në procedur me ju dhanë vërejtje gradualisht, nëse nuk i iplementojnë vërejtjet tona, duhet me ju shkëput kontratën, i ki prej 45 mujmë me dhanë 5 janë tamam, tjerët e merrtojnë vërejtjen prej ditës së parë, unë nuk jam me mbrojtë kërkanë dhe me ngarku kërkanë, në këtë raport unë në kuvend kam mi thanë edhe emrat e këtyre personave që i kanë në shfrytëzim në raport dhe duhet me thanë x personit duhet me ju shqëput kontrata, këtij duhet me ju dhanë vërejtje sepse nuk e ka shfrytëzu kontratën, ky e ka biznesin në emër të vetin e shfrytëzon x personi, këto janë çështje të ndishme dhe janë vepra penale, na nëse nuk ndërmarrim veprime na i këna pasojat, kështu që në këtë raport në detaj ki biznes që e ka marr një objekt dhe nuk e shfrytëzon, pse me blloku tokën, është çështje tjetër, na e këna marr një vendim dhe që duhet prap me marr, nuk këna qare pa e marr, kështu që detajet në kuvend kena me hi dhe me plotësu raportin, nja dy tri ditë dhe këna me dal me detaje veç e veç, na e këna ba mirë, muja me ju dhanë 6 apo 1 vjet por duhet me fut këtë projekt, këto që nuk kanë hy hiç duhet me shku në shkëputje dhe nuk ki shka mirresh me ta.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Sa biznese janë që si kanë shfrytëzu.

**Sabri Murseli** – Veç dy janë, se s'kanë kurgja prej tyre, kështu që të gjitha janë në raport, e në kuvend duhet ta marrim një vendim, qare nuk kemi pa e marr një vendim individual, unë them x personi nuk ka hy në shfrytëzim, këtij nuk mundemi me ja miratu.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Shumë biznese kanë falimentu dhe menzi janë rikoperu dhe menzi janë ngrit, po me rëndësi është tu e shfrytëzu qatë veprimtari që e ka kërku, qajo është e rëndësishme, unë e besoi dhe e di që shumica nuk e plotësojnë numrin e punëtorëve që e kanë paraqitë, po duhet me i mshel pak syt se është interes i tyre dhe i joni, se na duhet me u mundu mos me lan asnjë pa punë.

**Sabri Murseli** – Nuk do ta lam asnjë pa punë, po duhet me ja dhanë një vërejtje për implementim të kontratës.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Para sa vjete e ka marr pronën dhe nuk e ka shfrytëzu pse me ja lanë.

**Sabri Murseli** – Janë telashet e qirajave që nuk janë pagu edhe ato te Drejtoria e financave nuk kena bisedu me Drejtoreshen Sebahate, bile kanë kërku prej secilit veç e veç me i shiqu, a i kanë këto borgje dhe duhet me kalu me inkasim të dhunshëm, nuk ka zgjidhje tjetër, janë në qendër të qytetit këto biznese.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – A dëshiron dikush tjetër me diskutu për pikën e XII-të, urdhëro.

**Arian Imeri** – Faliminderit kryesues, në qoftëse na si kuvend, që duhet me marr parasysh mandatin edhe ma herët puna e këtyre pronave që i kena aprovu të dhanuna në bazë të biznesit, planeve dhe një kontratë që na u ka ofru, prandaj unë mendoj që t'i fus veprimet operative, ose këto kontrata ose një test kontratë që ju ka ofru, prandaj kryesues kur është fitu kontrata duhet me pas një udhëheqës, me i shiku me kohë raportet të vazhdueshme, a i plotëson kushtet a jo, nuk besoi që është kuvendi që veç e veç na me votu për secilin, nëse nuk është përmbush kontrata është personi kompetent me marr vendim, jam me ba një tolerancë për shkak të pandemisë dhe gjendjes së biznesit, vërejtje prej gjendjes së biznesit që janë përballur me shumë probleme të mëdhaja, kështu që jam me ba njëfarë tolerance, por siç e përmende drejtor, naj vërejtje apo diçka tjetër, e kështu që me ja dhanë edhe një mundësi dhe një afat, pra kush është përgjegjës për këto prona, një person një zyrtar që i përcjell këto kontrata.

**Sabri Murseli** – Jemi bazuar në Ligjin mbikëqyrës të këtyre kontratave, me angazhu një person bikëqyrës direkt, me këqyrë secilën kontratë veç e veç, tash qysh tek e organizon kryetari, Raporti në bazë të ligjit tash i ndalum është që kryetari e qet në kuvend, në bazë të ligjit që para 6 vjete është raporti i parë që po e paraqet në kuvend, më herët nuk e di a ka pas, është raporti i

parë që po e prezentojmë në kuvend, ku e njëjta kjo ka me u praqit nga auditorët pse nuk kena qit një raport ose të themi se ka dështu në këqyrjen e kontratave. Nëse i japim afat një vjet ja kërkojmë një plan të riorganizimit, ja paraqet kontratën dhe ndërmarrim masa, masën e parë nuk e bajna të fundit, por mujna me ba procedura që janë për me e tërhjek vërejtjen, pa përcjellës nuk shkon kështu.


**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Faliminderit drejtor, dikush tjetër, pra po e procesojmë për kuvend, kush është që pika XII-të të kaloi në kuvend; 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet pika e XII –të e rendit të ditës.

### **Pika 13**

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** –Në të ndryshme nuk ka diskutime, pra me kaq po e mbyllim mbledhjen e KPF-së.

**Procesmbajtësja**

  
**Zylha Tafarshiku**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**  
  
**Xhavit Zariqi**

